

BASHKIA MAT
NJOFTIM PËR DHËNIEN ME QIRA

“Për dhënie me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/ kullosor prej 2.55 ha, në ngastrën nr. 29/a, pjesë e Ekonomisë Pyjore Derjan 2, në administrim/pronësi të Bashkisë Mat”

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Mat
Adresa: Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel
Email: d.bujqësisë@bashkiamat.gov.al
Tel: 0692842093
2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 2.55 (dy pikë pesëdhjetë e pesë) ha, në parcelën nr. 29/a (nr.pasurie: 311), të Ekonomisë Pyjore Derjan 2, të fondit pyjor e kullosor në administrim/ pronësi të bashkisë Mat.
3. Qëllimi i dhënies me qira: me qëllim instalimin e impianteve fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike.
4. Afati i dhënies me qira: është 10 (dhjetë) vite, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
5. Vlera dysheme për detyrimin e qirasë: është 364 650 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në vit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, referuar afatit kohor të dhënies në përdorim dhe llojit të veprimtarisë që do të ushtrohet.

6. Konkurrimi për marrjen me qera do të kryhet në ambjentet e Bashkisë Mat në sallën e mbledhjes të Këshillit Bashkiak, më datë 15.06.2023, në orën 12:00.
7. Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:

Nr.	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pikë e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1.	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20 pikë
2.	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15 pikë
3.	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25 pikë
4.	Nivelin e punësimit në veprimtari	5 pikë
5.	Masën e qirasë për ha/vit	35 pikë

8. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:

I. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve (vërtetim të gjendjes gjyqësore, vërtetim nga prokuroria, gjykata, Drejtoria Rajonale Tatimore etj.)

II. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- Nivelin e punësimit në veprimtari;
- Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- Adresën e subjektit, telefon, email dhe faks;

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

9. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie me qira”, në zyrën e protokollit të Bashkisë Mat, dhe më pas i dorëzohet komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

Ofertat dorëzohen nga konkurenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

Data e zhvillimit të konkurrimit: 15.06.2023, ora 12:00, në ambientet e Bashkisë Mat, në sallën e mbledhjes të Këshillit Bashkiak.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 15.06.2023, ora 12.00.